



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
ëëë.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ven. nr. 01/2312 Dt. 01 / 10 / 2021

Mbështetur në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/37 të datës 24.9.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, respektivisht pika 20;

Mbështetur në rekomandimet e Konferencës së Rektorëve të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, datë 25.09.2021;

Senati i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen e XXVIII-të, mbajtur më datë 30.09.2021, mori:

V E N D I M

1. Viti i ri akademik 2021/22 në UKZ do të fillojë me datë 15 tetor 2021.
2. Procesi mësimor, respektivisht ligjëratat dhe ushtrimet, do të zhvillohen duke respektuar udhëzuesit përkatës, me kusht që numri i studentëve në një klasë mundëson në mënyrë rigoroz mbajtjen e distancës prej 1.5 metra në mes të personave.
3. Në rastet e caktuara, kur numri i studentëve është i madh, ligjëratat do të organizohen në dy nën-grupe të studentëve, brenda kohës së paraparë: ora e parë prej 40 minutave për grupin e parë të studentëve; ora e dytë prej 40 minutave për grupin e dytë të studentëve. Në mes të dy orëve të mundësohen 10 minuta pushim për ndërrimin e studentëve.
4. Në rastet tjera dhe varësisht edhe vendimeve të Qeverisë do të mbahen edhe orët hibride dhe online.
5. Dekanët gjatë përpilimit të orareve të ligjëratave dhe provimeve obligohen të mos lejojnë në kohë të njëjtë orë me grup të madh të studentëve.
6. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm që të zbatojë në gjithë hapësirën e kampusit të UKZ të gjitha masat anti Covid të përcaktuara nga vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.



Kryesuesi i Senatit

Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor